



VENDIM

Nr. 182, Datë 23.11.2016

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E
METODOLOGJISË SË PËRCAKTIMIT TË ÇMIMEVE PËR SHITJEN
E ENERGJISË ELEKTRIKE ME PAKICË TEK KLIENTËT QË
FURNIZOHEN NGA FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL.**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 19 gërma "b"; të ligjit Nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike"; VKM nr. 244 dt. 30.03.2016, "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrjnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", neneve 19 pika 1 gërma "a" dhe 26 të "Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE", miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016"; Bordi i ERE në mbledhjen e tij të datës 23.11.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e "draft- Metodologjisë së Përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë tek klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal", të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për miratimin e "draft- Metodologjisë së Përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë tek klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal". (bashkëlidhur drafti)
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim mund të ankimohet brenda 30 ditëve në Gjykatën Administrative.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI